



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“SHËRBIME MOTORI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**M1-III-22**

Tiranë, 2022

---

<sup>1</sup>Korniza Shqiptare e Kualifikimit

<sup>2</sup> Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime motori			Kodi M1-III-22
	Kohëzgjatja	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional në profilin “Shërbime motori, Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e motorit, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin mësimor “Shërbime motori” Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar dy vitet e para në arsimin profesional, drejtimi “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional.</li> <li>- mund të pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime motori”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës të nivelit të punonjësit të kualifikuar në këtë profil, të cilat njihen në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve të mjeteve të ndryshme të transportit, në ndërmarrje ku përdoren motorët me djegie të brendshme, në pika servisi të mjeteve të ndryshme të transportit, të mekanikës bujqësore, të shitjes së pjesëve të ndërrimit, si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në këtë drejtim.</p> <p>Me përfundimin e arsimimit të profilit “Shërbime motori”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individ ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/manaxherial) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti” dhe fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	M-II-01-11, M1-III-18			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Shërbime motori” niveli III, në KSHK, referuar nivelit III të KEK, do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet e motorit**

- Të tregojë rëndësinë e shërbimeve të motorit;
- Të klasifikojë shërbimet e motorit;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet e motorit;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe sistemimit të vendit të punës, sipas standardeve;
- Të përshkruajë organizimin dhe ndarjen e punës në një servis për shërbimet e motorit;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me teknikët dhe grupet e tjera të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit dhe monitorimit të shërbimeve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat për furnizimin me bazë materialo-teknike për shërbime të motorit;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit teknik për gatishmërinë e mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së pjesëve që zëvendësohen sipas kodeve përkatëse.

### **Veglat, pajisjet e punës, instrumentet matëse e kontrolluese dhe makineritë në shërbimet e motorit**

- Të listojë makineritë kryesore që përdoren në shërbimet e motorit, sipas funksionit të tyre;
- Të listojë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese në një servis për shërbimet e motorit;
- Të shpjegojë funksionin e veglave, pajisjeve të punës, instrumenteve matëse dhe kontrolluese, sipas manualit të prodhuesit;
- Të shpjegojë përdorimin e veglave, pajisjeve të punës dhe instrumenteve matëse e kontrolluese në një servis për shërbimet e motorit;
- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve të punës dhe instrumenteve matëse në një servis për shërbimet e motorit;
- Të listojë materialet kryesore që shërbejnë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës.

### **Kontrolli paraprak i gjendjes teknike të motorit në mjetet e transportit**

#### ***Të përgjithshme***

- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit paraprak të pjesëve të motorit;
- Të listojë llojet e kontrollit paraprak të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të motorit, duke përdorur mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë teknikat e matjeve me anën e instrumenteve të ndryshme kontrolluese;
- Të krahasojë vlerat e matura me vlerat nominale, sipas manualit të prodhuesit;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit nga burime të ndryshme;
- Të shpjegojë procedurat teknike të vendosjes së mjetit në urën e kontrollit;
- Të përshkruajë kontrollin paraprak të lidhjeve elektrike dhe hidraulike të motorit;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të motorëve me burime alternative të energjisë.

#### ***Në pjesët e palëvizshme të motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të lidhjeve të motorit me agregatet e tjera;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të hermetizimit të kokës së motorit me bllokun e cilindrave;
- Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e testimit të kokës së motorit dhe bllokut të cilindrave, për çarje të mundshme.

#### ***Në pjesët e lëvizshme të motorit (mekanizmat)***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementëve të mekanizmit bjellë - manivelë të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementëve të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të rrahjeve (goditjeve) në motor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të nyjeve të valvulave të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementeve të transmetimit të lëvizjes nga boshti i motorit deri tek boshti me gunga;
- Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të fazës së mekanizmit të shpërndarjes.

#### ***Në sistemin e ftohjes së motorit***

- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak për testimin nën presion të sistemit të ftohjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të radiatorit, tubave prej gome, valvulës termostat dhe elektroventilatorit /ventilatorit në sistemin e ftohjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pompës së ujit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gjendjes dhe të nivelit të lëngut ftohës në rezervuar.

#### ***Në sistemin e vajosjes së motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të depozitës së vajit, të guarnicionit dhe tapës së vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pompës së vajit dhe të valvulës së presionit të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të radiatorit ftohës të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gjendjes dhe të nivelit të vajit në depozitë.

#### ***Në sistemin e ushqimit të motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementeve të sistemit të ushqimit të motorit me karburator, me injeksion benzine dhe naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të depozitës së lëndës djegëse, të tubacioneve dhe rekorderive;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të filtrave të lëndës djegëse të sistemit të ushqimit të motorit me karburator, me injeksion benzine, me benzinë dhe gaz dhe me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pompës së presionit të ulët dhe pompës së presionit të lartë të sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit të ushqimit nëpërmjet shpërndarësit drejtvizor të naftës në injektor (Common Rail), në motorët me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pompës së sistemit të ushqimit me injeksion benzine;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të valvulës dhe rregullatorit të presionit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të injektorëve të sistemit të ushqimit të motorit me naftë, me benzinë dhe me gaz;

***Në sistemet e furnizimit me ajër me presion dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kolektorit të thithjes dhe të shkarkimit të ajrit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të valvulës së riqarkullimit të gazeve **EGR** (Exhaust Gas Recirculation);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të shndërruesit katalitik në motorët me benzinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të filtrit të grimcave të karbonit DPF (Diesel Particular Filter) në motorët me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sensorit të oksigjenit  $\lambda$  dhe sistemit AddBlue (lëng që redukton sasinë e ajrit të ndotur të krijuar në motorin diesel) dhe të sistemit të ventilimit mbi depozitën e vajit **PCV** (Positive Crankcase Ventilation);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kompresorit dhe turbokompresorit të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të filtrit të ajrit dhe elementëve të lidhur me të,
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tubave bashkues të katalizatorit dhe të marmitës.

***Në sistemin elektrik të motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të baterisë;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të alternatorit dhe rregullatorit të tensionit;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse të motorit;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kandeleve e të fijeve/shiritave të kandeleve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të kandeletave në motorët me naftë.

### **Punime (çmontim/montim, riparim dhe/ose zëvendësim) në sistemet e motorit**

#### ***Të përgjithshme***

- Të listojë llojet e punimeve në motor duke përshkruar rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve për punime në motor, sipas manualeve të prodhuesit;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit nga burime të ndryshme për punime në motor;
- Të përshkruajë radhën e punës të çmontim/montimit të motorit nga agregatet e tjerë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e çmontim/montimit të elementeve përbërës të pjesëve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve përbërës të pjesëve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e riparimit me axhustim, frezim, smerilim, saldim etj. me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të përshkruajë proceset e punimeve të regjistrimit, sipas karakteristikave teknike të shërbimeve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e shkëputjes dhe rivendosjes së lidhjeve elektrike;
- Të përshkruajë procedurat e përzgjedhjes së materialeve, pjesëve dhe lubrifikuesve për zëvendësim;
- Të përshkruajë procedurat e punimeve në motorët me burime alternative të energjisë;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik për punimet në motor;
- Të shpjegojë rëndësinë e provës së funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në pjesët e palëvizshme***

- Të listojë procedurat dhe mënyrat punimeve në pjesët e palëvizshme të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të kokës së motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të zëvendësimit të guarnicionit të kokës së motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dhomën e djegies në kokën e motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në dhomën ftohëse të bllokut të cilindrave dhe kokës së motorit;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në bllokun e cilindrave;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në këmishat e cilindrave;
- Të përshkruajë procesin dhe mënyrat e punimeve të frezimit dhe retifikimit të kokës së motorit dhe bllokut të cilindrave;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera,

#### ***Në pjesët e lëvizshme (mekanizmat)***

- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e mekanizmit bjellëmanivelë;

- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të boshtit motorik;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të nyjeve piston-bjellë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kanalet e kalimit të vajit të mekanizmit bjellë-manivelë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të nyjeve të valvulave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në boshtin me gunga;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve të elementeve të transmetimit të lëvizjes nga boshti motorik deri tek boshti me gunga;
- Të shpjegojë procedurën dhe mënyrën e vendosjes në fazë të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e ftohjes së motorit***

- Të përshkruajë procedurat për testimin nën presion të sistemit të ftohjes së motorit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në radiatorin e lëngut ftohës dhe tubat prej gome;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e valvulës termostat;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elektroventilator /ventilator;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën e ujit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e lëngut ftohës të motorit;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e vajosjes së motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në depozitën e vajit të motorit dhe tapën e shkarkimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën e vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e valvulës së presionit të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në radiatorin ftohës të vajit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e vajit në motor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e filtrave të vajit të motorit;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e ushqimit të motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me karburator;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me injeksion benzine dhe benzinë dhe gaz;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në depozitën e lëndës djegëse si dhe në tubacionet e rekorderitë e sistemit të ushqimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e filtrave të lëndës djegëse të motorit me karburator, me injeksion benzine, me gaz dhe me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në karburator;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën e presionit të ulët të sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën e presionit të lartë të sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e ushqimit nëpërmjet shpërndarësit drejtvizor të naftës në injektor (Common Rail), në motorët me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në pompën e benzinës të sistemit të ushqimit me injeksion benzine;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në valvulën e presionit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në rregullatorin e presionit të lëndës djegëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në injektorët e naftës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në injektorët e benzinës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në injektorët e sistemit të ushqimit me gaz;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin e furnizimit me ajër me presion dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kolektorin e thithjes së ajrit;
- Të përshkruajë rëndësinë e punimeve në elementët e sistemit të shkarkimit të produkteve të djegies;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kolektorin e shkarkimit si dhe për zëvendësimin e guarnicioneve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në valvulën e riqarkullimit të gazeve EGR (Exhaust Gas Recirculation);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e shndërruesit katalitik në motorët me benzinë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e filtrit të grimcave të karbonit DPF (Diesel Particular Filter) në motorët me naftë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sensorin e oksigjenit  $\lambda$ ;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësime të elementëve në sistemin e ventilimit mbi depozitën e vajit PCV (Positive Crankcase Ventilation);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tubat bashkues të katalizatorit dhe të marmitave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve që kryhen në kompresor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve që kryhen në turbokompresor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e filtrit të ajrit;



- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të avujve të lëndës djegëse;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

***Në sistemin elektrik te motorit:***

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në bateri;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në alternator;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e rregullatorit të tensionit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e lëshimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sistemin e sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse;
- Të përshkruajë procedurën dhe mënyrat e punimeve në kandelet dhe në fijet e tyre;
- Të përshkruajë procedurën dhe mënyrat e punimeve në distributor dhe bobinë;
- Të përshkruajë procedurën dhe mënyrat e punimeve për zëvendësimin e kandeletave në motorët me naftë;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit pas punimeve të kryera;

**Shërbime të mirëmbajtjes së motorëve në mjetet e transportit**

- Të vlerësojë shërbimet e mirëmbajtjes së motorit dhe rëndësinë e tyre;
- Të klasifikojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes së motorit;
- Të shpjegojë mënyrat e marrjes së informacionit nga manualët e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes së motorit;
- Të përshkruajë llojet e pastrimeve, mënyrat dhe mjetet e nevojshme për kryerjen tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve periodike në mirëmbajtjen e motorit në varësi të përdorimit të tij (km, orë pune etj.);
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në pjesët e palëvizshme të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në mekanizmat e motorit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ftohjes;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e vajisjes;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ushqimit të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e furnizimit me ajër dhe sistemin e shkarkimit të gazrave;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në burimet e energjisë elektrike të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e lëshimit;
- Të përshkruajë realizimin e provës së funksionimit pas shërbimit kryer të mirëmbajtjes;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik pas shërbimit të kryer.

**Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas standardeve në fuqi;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të listojë llojet e aksidenteve kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të motorit, si dhe mënyrat e shmangies së tyre;
- Të shpjegojë mënyrat dhe mjetet e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;

- Të shpjegojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në rast emergjence;
- Të përshkruajë rreziqet nga zjarri, që vijnë nga ambientet me gaz, nga energjia elektrike, nga materialet ndezëse (shkrepëse, çakmakë etj.);
- Të përshkruajë rregullat e parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH);
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me vegla dhe pajisje nën tension;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme etj.;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, substancë kimike etj.);
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen dhe depozitimin e mbetjeve të procesit të punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe të energjisë së përdorur;
- Të përshkruajë rreziqet nga ndotja e ambientit dhe masat për eliminimin e ndotjes;
- Të përshkruajë llojet e tabelave të sigurisë teknike;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie.

### **Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës**

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë veçoritë e mjedisit social, ekonomik ku zhvillohet sipërmarrja e biznesit;
- Të përshkruajë nevojat dhe mënyrat e plotësimit të kërkesave të klientëve;
- Të shpjegojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë mënyrën dhe formatet e përgatitjes së raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të shpjegojë llojet e shërbimeve kryesore me institucionet financiare, lidhur me aktivitetin e biznesit;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të përshkruajë llojet e dixhitalizimit të pagesave dhe ndikimin që sjellin ato në zhvillimin e aktivitetit të një biznesi;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të çmimit të tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të shpjegojë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me koston e materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të shpjegojë rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;

- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet në motor;
- Të përshkruajë rëndësinë e plotësimit dhe të dorëzimit të dokumentacionit teknik dhe financiar të punimeve të kryera;

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe mënyrat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të TIK dhe teknologjive të reja të komunikimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët, si dhe rregullat e zgjidhjes së konflikteve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;
- Të përshkruajë Kodin e Etikës, rëndësinë e zbatimit të tij;
- Të përshkruajë mënyrat e regjistrimit të ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave/teknologjive të reja në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Shërbime motori” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të jetë i aftë:

### **Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet e motorëve**

- Të organizojë vendin e punës për shërbime në motor;
- Të zbatojë standardet e profesionit të motoristit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për punimet në motor;
- Të konsultohet me teknikët e grupet e tjera të punës;
- Të zbatojë mënyrën e planifikimit, organizimit dhe monitorimit të veprimtarisë;
- Të zbatojë veprimtaritë sipas planifikimit ditor, javor, mujor etj. dhe prioriteteve;
- Të kryejë veprimet për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet në motor;
- Të zbatojë procedurat për vendosjen e mjetit në vendin e kontrollit për shërbimet në motor;
- Të zbatojë procedurat/rregullat për pranimin e mjetit për kontroll paraprak;
- Të zbatojë rregullat e kontrollit dhe sigurimit të gjendjes teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës për shërbimet në motor;
- Të hartojë një preventiv punimi me elementët përbërës, duke kryer llogaritjet përkatëse;
- Të zbatojë radhën e punës dhe fazat e realizimit të punimit.

### **Veglat, pajisjet, makineritë e punës dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese në shërbimet e motorit**

- Të përzgjedhë veglat, pajisjet e punës, makineritë dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese sipas funksionit të tyre;
- Të përdorë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet e motorit, sipas manualit të prodhuesit;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për pastrimin dhe mirëmbajtjen e veglave, të pajisjeve të punës dhe instrumentet matëse.
- Të mirëmbajë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet e motorit;
- Të zbatojë manualët e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve ndihmëse në një servis për shërbimet e motorit;

### **Kontrollet paraprake të sistemeve të motorit**

#### ***Të përgjithshme***

- Të kryejë kontrollet paraprake të sistemeve të motorit me mënyra të ndryshme;
- Të zbatojë udhëzimet dhe procedurat e dhëna të në manualët e prodhuesit për punimet në motor;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të mjetit;
- Të marrë informacione nga burime të ndryshme për defektet në motor;
- Të realizojë matjet dhe kontrollin paraprak të sistemeve të motorit, duke përdorur pajisjet përkatëse;
- Të interpretojë vlerat e matura me referencat e manualit të prodhuesit;
- Të përcaktojë (lokalizojë) parregullsitë në sistemet e motorit;
- Të zgjedhë mënyrën më ekonomike dhe ekologjike të riparimit;
- Të zbatojë procedurat e vendosjes së mjetit në urën e kontrollit;
- Të kryejë kontrollet paraprake të lidhjeve elektrike dhe hidraulike në shërbimet e motorit;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të motorëve me burime alternative të energjisë.

#### ***Në pjesët e palëvizshme të motorit***

- Të kryejë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të pjesëve të palëvizshme të motorit;
- Të kryejë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të lidhjeve të motorit me agregatet e tjera;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të hermetizimit të kokës së motorit me bllokun e cilindrave;
- Të realizojë teknikat dhe mënyrat e testimit të kokës së motorit dhe bllokut të cilindrave për çarje të mundshme;

#### ***Në pjesët e lëvizshme (mekanizmat)***

- Të realizojë kontrollin paraprak të elementëve të mekanizmit bjellë - manivelë të motorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të elementëve të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit;
- Të kryejë kontrollin paraprak të rrahjeve (goditjeve) në motor;
- Të realizojë kontrollin paraprak të nyjeve të valvulave të motorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të elementeve të transmetimit të lëvizjes nga boshti i motorit deri tek boshti me gunga;
- Të realizojë kontrollin e vënies në fazë të motorit;
- Të realizojë kontrollin e shkallës së komprimimit të cilindrave.

### ***Në sistemin e ftohjes së motorit***

- Të realizojë kontrollin me testim nën presion të sistemit të ftohjes;
- Të realizojë kontrollin e radiatorit, tubave prej gome, valvulës termostat dhe elektroventilatorit /ventilatorit në sistemin e ftohjes;
- Të realizojë kontrollin e pompës së ujit;
- Të realizojë kontrollin e gjendjes dhe të nivelit të lëngut ftohës në rezervuar.

### ***Në sistemin e vajosjes së motorit***

- Të realizojë kontrollin e depozitës së vajit, të guarnicionit dhe tapës;
- Të realizojë kontrollin e pompës së vajit dhe të valvulës së presionit;
- Të realizojë kontrollin e radiatorit ftohës të vajit;
- Të realizojë kontrollin e gjendjes dhe të nivelit të vajit në depozitën e tij.

### ***Në sistemin e ushqimit të motorit***

- Të realizojë kontrollin në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me karburator, me injeksion benzine dhe me naftë;
- Të realizojë kontrollin në depozitën e lëndës djegëse, në tubacionet dhe rekorderitë;
- Të realizojë kontrollin e filtrave të lëndës djegëse të sistemit të ushqimit të motorit me karburator, me injeksion benzine, me benzinë dhe gaz, si dhe me naftë;
- Të realizojë kontrollin në pompën e presionit të ulët dhe pompën e presionit të lartë të sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të realizojë kontrollin në sistemin e ushqimit nëpërmjet shpërndarësit drejtvizor të naftës në injektor (Common Rail), në motorët me naftë;
- Të realizojë kontrollin në pompën e sistemit të ushqimit me injeksion benzine;
- Të realizojë kontrollin në valvulën dhe rregullatorin e presionit të lëndës djegëse;
- Të realizojë kontrollin në injektorët e sistemit të ushqimit të motorit me naftë, me benzinë dhe me gaz;

### ***Në sistemin e furnizimit me ajër me presion dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit***

- Të realizojë kontrollin e kolektorit të thithjes së ajrit dhe të shkarkimit të produkteve të djegies;
- Të realizojë kontrollin e valvulës së riqarkullimit të gazeve EGR (Exhaust Gas Recirculation);
- Të realizojë kontrollin e shndërruesit katalitik në motorët me benzinë;
- Të realizojë kontrollin e filtrit të grimcave të karbonit DPF (Diesel Particular Filter ) në motorët me naftë;
- Të realizojë kontrollin e sensorit të oksigjenit  $\lambda$  dhe sistemit AddBlue (lëng që redukton sasinë e ajrit të ndotur të krijuar në motorin diesel) dhe të sistemit të ventilimit të depozitës së vajit **PCV** (Positive Crankcase Ventilation );
- Të realizojë kontrollin e kompresorit dhe turbokompresorit të motorit;
- Të realizojë kontrollin e filtrit të ajrit dhe elementëve të lidhur me të,
- Të realizojë kontrollin në tubat bashkues të katalizatorit dhe të marmitës.

### ***Në sistemin elektrik të motorit***

- Të realizojë matjet elektrike dhe kontrollin e baterisë;
- Të realizojë e kontrollit paraprak të alternatorit dhe rregullatorit të tensionit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit të lëshimit të motorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse të motorit;
- Të realizojë kontrollin paraprak të kandeleve e të fijeve/shiritave të kandeleve;

- Të realizojë kontrollin paraprak të kandeletave në motorët me naftë.

## **Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në sistemet e motorit**

### ***Të përgjithshme***

- Të përcaktojë llojet e punimeve në motor;
- Të zbatojë standartet sipas manualeve të prodhuesit për punime në motor;
- Të vlerësojë marrjen e informacionit nga burime të ndryshme për punime në motor;
- Të zbatojë radhën e punës të çmontim/montimit të motorit nga agregatet e tjerë;
- Të realizojë çmontim/montimit të elementeve përbërës të pjesëve të motorit;
- Të realizojë zëvendësimi të elementeve përbërës të pjesëve të motorit;
- Të realizojë punime me axhustim, frezim, smerilim, saldim etj. me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të realizojë punime regjistrimi sipas karakteristikave teknike në shërbimet në motor;
- Të realizojë punime për shkëputjen dhe rivendosjen e lidhjeve elektrike;
- Të përzgjedhë materialet, pjesët dhe lubrifikantet që përdoren në shërbimet në motor sipas specifikimeve teknike të dhëna në manualët përkatëse;
- Të realizojë punime në motorë me burime alternative të energjisë;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet në motor.

### ***Në pjesët e palëvizshme***

- Të realizojë punime në kokën e motorit;
- Të realizojë punime të zëvendësimit të guarnicionit të kokës së motorit;
- Të realizojë punime në dhomën e djegies në kokën e motorit;
- Të realizojë punime në dhomën ftohëse të bllokut të cilindrave dhe kokës së motorit;
- Të realizojë punime në bllokun e cilindrave;
- Të realizojë punime në këmishat e cilindrave;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

### ***Në pjesët e lëvizshme (mekanizmat)***

- Të realizojë punime në boshtin motorik;
- Të realizojë punime të nyjeve piston-bjellë;
- Të realizojë punime në kanalet e kalimit të vajit në elementë e mekanizmit bjellë-manivelë;
- Të realizojë punime të nyjeve të valvulave;
- Të realizojë punime në boshtin me gunga;
- Të realizojë punime në elemente të transmetimit të lëvizjes nga boshti motorik deri tek boshti me gunga;
- Të realizojë vendosjen në fazë të motorit;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

### ***Në sistemin e ftohjes së motorit***

- Të realizojë punime në radiatorin e lëngut ftohës dhe në tubat prej gome;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e valvulës termostat;
- Të realizojë punime në elektroventilator/ventilator;
- Të realizojë punime në pompën e ujit;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e lëngut ftohës të motorit;

- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e vajosjes së motorit***

- Të realizojë punime në depozitën e vajit të motorit dhe tapën e shkarkimit të vajit;
- Të realizojë punime në pompën e vajit;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e valvulës së presionit të vajit;
- Të realizojë punime në radiatorin ftohës të vajit;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e vajit në motor;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e filtrit të vajit të motorit;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e ushqimit të motorit***

- Të realizojë punime në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me karburator;
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të ushqimit të motorit me injeksion benzine ( SPI, MPI, DI ), me benzinë dhe gaz;
- Të realizojë punime pastrimi/zëvendësimi në depozitën e lëndës djegëse, si dhe në tubacionet e rekorderitë;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e filtrave të lëndës djegëse të motorit me karburator, me injeksion benzine, me gaz dhe me naftë;
- Të realizojë punime pastrimi/zëvendësimi në karburator;
- Të realizojë punime në pompën e presionit të ulët të sistemit të ushqimit të motorit me naftë;
- Të realizojë punime në pompën e presionit të lartë të sistemit të ushqimit të motorit me naftë
- Të realizojë punime në sistemin e ushqimit nëpërmjet shpërndarësit drejtvizor të naftës në injektor (Common Rail), në motorët me naftë;
- Të realizojë punime në pompën e sistemit të ushqimit me injeksion benzine (SPI, MPI, DI);
- Të realizojë punime në valvulën e presionit të lëndës djegëse;
- Të realizojë punime në rregullatorin e presionit të lëndës djegëse;
- Të realizojë punime pastrimi/zëvendësimi në pompën zhytëse në depozitën e lëndës djegëse;
- Të realizojë punime pastrimi/zëvendësimi në injektorët e naftës;
- Të realizojë punime pastrimi/zëvendësimi në injektorët e benzinës;
- Të realizojë punime pastrimi /zëvendësimi në injektorët e sistemit të ushqimit me gaz;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin e furnizimit me ajër me presion dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit***

- Të realizojë punime në kolektorin e thithjes së ajrit;
- Të realizojë punime në kolektorin e shkarkimit të produkteve të djegies dhe të guarnicioneve;
- Të realizojë punime në valvulën e riqarkullimit të gazeve EGR (Exhaust Gas Recirculation);

- Të realizojë punime në shndërruesin katalitik në motorët me benzinë;
- Të realizojë punime në filtrin e grimcave të karbonit DPF (Diesel Particular Filter ) në motorët me naftë;
- Të realizojë punime në sensorin e oksigjenit  $\lambda$
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të ventilimit të depozitës së vajit PCV (Positive Crankcase Ventilation);
- Të realizojë punime në tubat bashkues të katalizatorit dhe të marmitave;
- Të realizojë punime në kompresor;
- Të realizojë punime në turbokompresor;
- Të realizojë punime zëvendësimi në filtrin e ajrit,
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të kontrollit elektronik të avujve të lëndës djegëse;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### ***Në sistemin elektrik të motorit***

- Të realizojë punime në bateri;
- Të realizojë punime në alternator;
- Të realizojë punime në sistemin e lëshimit;
- Të realizojë punime në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse;
- Të realizojë punime në kandelet dhe fijet/ shiritat e tyre;
- Të realizojë punime në distributor dhe bobinë;
- Të realizojë punime për zëvendësimin e kandeletave në motorët me naftë;
- Të realizojë provën e funksionimit pas punimeve të kryera.

#### **Shërbime të mirëmbajtjes së motorëve në mjetet e transportit**

- Të përcaktojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes së motorit;
- Të realizojë shërbimet periodike në mirëmbajtjen së motorit, në varësi të përdorimit (km, orë pune, etj.);
- Të realizojë marrjen e informacionit nga manualët e prodhuesit dhe burime të tjera informacioni për shërbimet e mirëmbajtjes së motorit;
- Të realizojë pastrimin e pjesëve motorike sipas procedurave, me mjetet e nevojshme;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në pjesët e palëvizshme të motorit;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në mekanizmat e motorit;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ftohjes;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e vajosjes;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ushqimit të motorit;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e furnizimit me ajër dhe sistemin e shkarkimit të gazrave;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në burimet e energjisë elektrike të motorit;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e ndezjes/ përzierjes djegëse;
- Të realizojë procedurat e mirëmbajtjes në sistemin e lëshimit;
- Të realizojë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik pas shërbimit të kryer;
- Të realizojë provën e funksionimit pas shërbimit të kryer të mirëmbajtjes.

#### **Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës**

- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e mirëmbajtjes dhe



riparimit të motorit;

- Të realizojë procedurat e furnizimit me pjesë këmbimi dhe materiale bazë të nevojshme;
- Të hartojë planet ditore, javore, mujore të punës në përputhje me detyrat;
- Të zbatojë procedurat e duhura në dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe financiar të punimeve të kryera;
- Të bashkëpunojë me institucionet financiare për aktivitetin e biznesit;
- Të zbatojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të regjistrojë të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të përgatisë raporte periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të kontrollojë çmimet e tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me koston e materialeve të punës pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të përgatisë një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të përzgjedhë mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të përdorë programet digjitale për pagesat në zhvillimin e aktivitetit të biznesit, sipas rastit;

### **Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në shërbimet e motorit në mjetet e transportit;
- Të zbatojë rregullat për shmangien e aksidenteve kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të motorit të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);
- Të zbatojë rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, kur punohet në ambientet me gaz, me energji elektrike, me materialet ndezëse (shkrepëse, cakmakë, etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me energji elektrike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme, etj.;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes, magazinimit dhe sigurisë në punë, gjatë punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, solucionet kimike etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të kryejë procedurat e duhura për ndarjen dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të zbatojë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve, sipas rregullave përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racionale lëndët e para, pjesët e këmbimit (të reja dhe të përdorura), energjinë etj.;

- Të zbatojë masat përkatëse kundër ndotjes së mjedisit;
- Të zbatojë rregullat dhe tabelat e sigurisë teknike në vendin e punës;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të zbatojë rregullat e komunikimit etik dhe profesional në punë;
- Të përdorë teknologjitë e reja të komunikimit, duke përfshirë TIK;
- Të shkëmbejë me kolegët informacione mbi problemet dhe të reja të ditës;
- Të zbatojë udhëzimet/procedurat për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë hierarkinë dhe rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;
- Të zbatojë Kodin e Etikës në komunikimin/ sjelljen me kolegët, drejtuesit, klientët, si dhe në paraqitjen e jashtme në vendin e punës;
- Të komunikojë me etikë profesionale për zgjidhjen mosmarrëveshjeve dhe konflikteve;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
- Të përditësojë njohuritë për të aplikuar teknikat/ teknologjitë e reja në punë;
- Të marrë pjesë në trajnimet për të rritur kualifikimin tij në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit;
- Të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij.

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

Të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij duke manifestuar gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup duke bashkëpunuar për arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;